



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJILAN

P.nr. 357/2023

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE GJILAN - Departamenti i Përgjithshëm, përmes gjyqtarit të vetëm gjykues Behar Ymeri, me bashkëpunëtoren profesionale Kadishe Ajvazi Demi, në lëndën penale kundër të pandehurve E.N...nga fshati V...., komuna e Gj..., për shkak të veprës penale, Rrezikim i trafikut publik nga neni 370 paragrafi 8 lidhur me paragrafin 6 dhe 1 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK) të cilin e mbron av. Hajredin Leka i caktuar sipas autorizimit dhe G.M...nga fshati Ll..., komuna e Gj..., për shkak të veprës penale Rrezikim i trafikut publik nga neni 370 paragrafi 8 lidhur me paragrafin 6 dhe 1 të KPRK-s, të cilin e mbron me autorizim zëvendësues av. Jehona Sylejmani, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore Departamenti i Përgjithshëm në Gjilan, PP.II.nr.1554/2022, të datës 22.05.2023, të cilën e përfaqëson Prokurorja e Shtetit Leonora Kadriu, pas mbajtjes së seancës fillestare dhe publike, më datën 03.08.2023, mori dhe publikisht shpalli këtë:

A K T G J Y K I M

I pandehuri G.M..., i biri i S... dhe nënës Sh..., e lindur V..., i lindur me datë ..., në Gj..., me vendbanim në fshatin Ll..., komuna e Gj..., ka të kryer shkollën e mesme, me punë të përkohshme në F..., i gjendjes së mesme ekonomike, i martuar, baba i një fëmije, me numër personal ..., shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, më parë i dënuar dhe nuk udhëhiqet procedurë penale ndaj tij.

ËSHTË FAJTOR

Sepse më datë 04.Gusht 2022, rreth orës 09.15 minuta, në Lagjen Arbëria në Gjilan, i pandehuri G.M..., ka rrezikuar trafikun publik duke vënë në rrezik jetën e njerëzve dhe pasurinë e tyre, në atë mënyrë që duke drejtuar automjetin e markës BMW 390 X me tabela të regjistrimit BB-104-ZH nga pakujdesia dhe në kundërshtim me nenin 55 paragrafi 1 të Ligjit për rregullat e trafikut rrugor, i cili përcakton se shpejtësia me e madhe e lejuar brenda zonës urbane është 50 km/h në qoftëse me shenja të trafikut nuk është përcaktuar ndryshe, ashtu që për shkak të shpejtësisë së zhvilluar nuk ka mundur që të ndalojë me kohë veturën e tij dhe ndeshet në anësoren e majtë afër derës së parë me automjetin e markës BMW X5 me tabela të regjistrimit 06-819-CP, të cilin e ngiste i pandehuri R.N...i cili kishte filluar të lidhet në rrugën kryesore pa u siguruar me parë se mund ta bejë këtë pa rrezikuar përdoruesit e tjerë të rrugës dhe si pasojë e kësaj nga lëshimet e lartpërmendura të të pandehurit, përveç dëmeve materiale në automjete dhe lëndimeve të pësuar vet i pandehuri, lëndime të rënda trupore pëson Sh.M..., ndërsa e dëmtuara A.M...ka pësuar lëndime të lehta trupore të cilët për shkak të lëndimeve të pësuar janë dërguar për trajtim mjekësor në Emergjencën e Spitalit Regjional në Gjilan

me çka ka kryer veprën penale, Rrezikim i trafikut publik nga neni 370 paragrafi 8 lidhur me paragrafin 6 dhe 1 të KPRK-s.

Andaj, gjykata në bazë dispozitës së lartcekur ligjore dhe neneve 4, 38, 40, 42, 44, 64, 69, 70, 71, 72 dhe 79 të KPRK-s, si dhe 364 të KPP, të akuzuarin.

E G J Y K O N

I. Të akuzuarin **G.M...** për veprën penale Rrezikim i trafikut publik nga neni 370 paragrafi 8 lidhur me paragrafin 6 dhe 1 të KPRK-s, i shqiptohet dënimi me burg në kohëzgjatje prej 150 (njëqind e pesëdhjetë) ditë.

II. Në bazë të nenit 44 të KPRK-s, dhe me pëlqimin e akuzuarit G.M..., dënimi me burg në kohëzgjatje prej 150 (njëqind e pesëdhjetë) ditë, i **ZËVENDËSOHET** në dënimi me gjobë në shumë prej 400 € (katërqind) euro, i cili dënimi do të ekzekutohet pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

III. Konform nenit 64 të KPRK-s, të akuzuarit i shqiptohet Dënimi plotësues Ndalim i Drejtimit të Automjetit në periudhë prej 1 viti, i cili dënimi do të ekzekutohet pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

IV. Palët e dëmtuara për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohen në kontest civil.

V. Obligohet i akuzuari që të paguaj taksën për Kompensimin e Viktimave të krimit në shumë prej 20.00 (njëzetë) euro, në afat prej 15 ditë pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarimit të dhunshëm.

VI. Obligohet i akuzuari që në mënyrë solidarë të paguaj shpenzimet e procedurës penale për ekspertizë të komunikacionit shumën prej 130.00 € (njëqind e tridhjetë) euro si dhe për ekspertizën mjeko-ligjore shumën prej 70.00 € (shtatëdhjetë) euro, si dhe paushallin gjyqësor në shumën prej 20.00 € (njëzetë) euro, në afat prej 15 ditë pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarimit të dhunshëm.

VECOHET PROCEDURA PENALE ndaj të pandehurit R.N...me vendbanim në fshatin V..., komuna e Gj..., për shkak të veprës penale Rrezikim i trafikut publik nga neni 370 paragrafi 8 lidhur me paragrafin 6 dhe 1 të KPRK-s, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Gjilan/Departamenti i Përgjithshëm, PP.II.nr.1554/2022, të datës 22.05.2023 kundër aktvendimit nuk është lejuar ankesa.

A R S Y E T I M

1. Rrjedha e çështjes dhe fjala përfundimtare e palëve

Prokuroria Themelore në Gjilan, Departamenti i Përgjithshëm, me datë 22.05.2023, ka ngritur aktakuzë, me numër të lëndës PP.II.nr.1554/2022, kundër të akuzuarve R.N...nga fshati V..., komuna e Gj..., për shkak të veprës penale, Rrezikim i trafikut publik nga neni 370 paragrafi 8 lidhur me paragrafin 6 dhe 1 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK) dhe G.M...nga fshati Ll..., komuna e Gj..., për shkak të veprës penale rrezikim i trafikut publik nga neni 370 paragrafi 8 lidhur me paragrafin 6 dhe 1 të KPRK-s.

Në shqyrtimin fillestar gjykata e ka veqar procedurën penale ndaj të pandehurit R.N...për shkak se i pandehuri G.M...në shqyrtimin fillestar e ka pranuar fajësinë për kryerjen e veprës penale me të cilën është ngarkuar në dispozitivin II të aktakuzës, ndërsa i pandehuri R.N...në shqyrtimin fillestar nuk e ka pranuar fajësinë për kryerjen e veprës penale si në dispozitivin I të aktakuzës, pasi që i pandehuri G.M...jeton në F..., me qëllim të efikasitetit dhe ekonomizimit të procedurës penale, gjyqtari vendosi mbi veqimin e procedurës në bazë të nenit 36 të KPP-s.

Gjykata ka mbajtur shqyrtimin fillestar dhe publik më datën 03.08.2023, në të cilin shqyrtim kanë prezantuar prokurorja e shtetit Leonora Kadriu, të pandehurit R.N..., me mbrojtësin e tij av.Hajredin Leka dhe G.M...me mbrojtësen e tij av. Jehona Sylejmani dhe e dëmtuara Sh.M.... Pas leximit të aktakuzës nga prokurorja e shtetit, në këtë seancë, i pandehuri G.M...ka deklaruar se e pranon fajësinë për kryerjen e veprës penale si në dispozitivin II të aktakuzës së Prokurorisë së Shtetit.

2. Vlerësimi i pranimi të fajësisë

Në shqyrtimin fillestar dhe publik, gjyqtari i vetëm gjykues pas dëgjimit të prokurores së shtetit, të dëmtuarës dhe mbrojtësit të të pandehurit ka marrë aktvendim me të cilin ka pranuar fajësinë e të pandehurit G.M..., për kryerjen e veprës penale për të cilën akuzohet, ngase ka konstatuar se janë plotësuar gjitha kushtet ligjore për një gjë të tillë. Në këtë aspekt gjyqtari i vetëm gjykues ka konstatuar se i pandehuri e ka kuptuar drejtë natyrën dhe pasojat e pranimi të fajësisë, se pranimi i fajësisë është bërë vullnetarisht, se i pandehuri nuk ka qenë i detyruar as i shtrënguar në asnjë mënyrë që të pranojë fajësinë, se pranimi i fajësisë mbështet në faktet e çështjes të cilat i përmban aktakuza dhe se aktakuza nuk përmban ndonjë shkelje ligjore dhe gabime faktike.

3. Gjendja faktike e vërtetuar

Andaj, duke u bazuar në këto që u cekën më lartë, gjykata e ka vërtetuar këtë gjendje faktike, duke u bazuar në format e kualifikuara të kësaj veprë, ekziston fakti se i pandehuri G.M..., ka kryer veprën penale rrëzikim i trafikut publik nga neni 370 paragrafi 8 lidhur me paragrafin 6 dhe 1 të KPRK-s. dhe ka shkelur dispozitat nga neni 55 paragrafi 1 të Ligjit për rregullat e Trafikut rrugor të Kosovës.

4.Elementet e veprës penale

Gjykata, pas dëgjimit të deklaratave të palëve lidhur me dënimin, ka shpallur fajtor të akuzuarin G.M..., për shkak të veprës penale rrëzikim i trafikut publik nga neni 370 paragrafi 8 lidhur me paragrafin 6 dhe 1 të KPRK-s, dhe ka shkelur dispozitat nga neni 55 paragrafi 1 të Ligjit për rregullat e Trafikut Rrugor të Kosovës ngase veprimet e të njëjtit i përmbajnë të gjitha tiparet e veprës penale dhe se për të njëjtat është dhe penalisht përgjegjës.

5. Rrethanat që janë marrë për bazë me rastin e shqiptimit të dënimit

Gjyqtari i vetëm gjykues, me rastin e shqiptimit të dënimit duke u bazuar në nenit 69,70,71 dhe 72 të KPRK-s, ka vlerësuar se duhet të pranohet pranimit i fajësisë nga ana e të akuzuarit dhe të njëjtit ti shqiptohet dënim si në dispozitiv të aktgjykimit, ngase duke i marrë parasysh të gjitha rrethanat dhe provat ky dënim do të jetë dënim i drejtë dhe në harmoni me peshën e veprës penale, ashtu që për të akuzuarin G.M...si rrethanë lehtësuese ka marrë faktin se e dëmtuara nuk i është bashkangjitur ndjekjes penale ndaj të pandehurit, i akuzuari e ka pranuar fajësinë për veprën penale për të cilën akuzohet, keqardhjen e ndër për rastin e ndodhur, i ka kërkuar falje të dëmtuarve dhe i ka premtuar gjykatës që në të ardhmen do të jetë më i kujdesshem në drejtimin e automjeteve, më parë nuk ka ra ndesh me ligjin dhe i ka premtuar gjykatës se nuk do të kryej vepra tjera penale, ndërsa si rrethana rënduese gjykata gjeti mënyrën e kryerjes së veprës penale, shkaktimin e pasojave-lëndimet trupore të dëmtuarve, rrezikshmërinë shoqërore të veprës penale dhe përgjegjësinë penale.

6.Shqiptimi i dënimit në harmoni me peshën e veprës penale dhe me shkallën e përgjegjësisë penale të akuzuarit dhe qëllimi i dënimit të shqiptuar

Sipas bindjes së gjyqtarit të vetëm gjykues dënimi i shqiptuar ndaj të akuzuarit G.M... duke marrë parasysh rrethanat e përmendura më lartë është dënim i drejtë dhe në harmoni me peshën e veprës penale dhe shkallën e përgjegjësisë penale të akuzuarit.

Gjyqtari po ashtu ka konstatuar se me këtë dënim mund të arrihet qëllimi i dënimit nga neni 38 të KPRK-s, i cili konsiston në parandalimin e të akuzuarit nga kryerja e veprave penale dhe rehabilitimin e tij, parandalimin e personave të tjerë nga kryerja e veprave penale, shprehja e gjykimit shoqëror për veprën penale dhe ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

7.Vendimi mbi kërkesën pasurore juridike

Gjykata lidhur me kërkesën pasurore juridike vendosi konform nenit 462 paragrafi 1 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës.

8.Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale

Duke e pasur natyrën e kësaj çështje penale, gjykata, duke u bazuar nënenin 452 paragrafi 1 të KPP, ka obliguar të pandehurin që solidarisht ti paguaj shpenzimet e procedurës penale, dhe paushallin gjyqësor si dhe konform Ligjit për Kompensimin e Viktimave të Krimit të paguaj taksën për viktimat e krimit (Ligji nr.08/L-109), të gjitha në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, nga dita kur ky aktgjykim të bëhet i formës së prerë.

Duke u bazuar në këto që u cekën më lart, është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN

Departamenti i Përgjithshëm

P.nr. 357/2023, më datën 03.08.2023

Bashkëpunëtorë profesionale,
Kadishe Ajvazi Demi

Gjyqtari,
Behar Ymeri d.v

KËSHILLA JURIDIKE; Kundër këtij aktgjykimi mund të paraqitet ankesë në Gjykatën e Apelit në Prishtinë / Departamentit të përgjithshëm në afat prej 30 ditëve nga dita e pranimit e të njëjtit. Ankesa në kopje të mjaftueshme i paraqitet kësaj gjykate.